

REZOLUTË

PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË KOMISIONIT TË SHËRBIMIT CIVIL PËR VITIN 2004

Kuvendi i Shqipërisë,

- duke njohur dhe mbështetur rolin e pazëvendësueshëm të Komisionit të Shërbimit Civil në mbikëqyrjen e menaxhimit të shërbimit civil;
- duke vlerësuar rolin e këtij institucioni të pavarur si arbitër administrativ për zgjidhjen e ankesave ndaj vendimeve në lidhje me nëpunësin civil;
- duke insistuar në domosdoshmërinë e zhvillimit të reformave në administratën publike, në kuadër të procesit të integritetit në Bashkimin Europian;
- duke theksuar rëndësinë e forcimit të marrëdhënieve ndërinstitucionale ndërmjet Komisionit të Shërbimit Civil dhe institucioneve të tjera ligjvënëse, ekzekutive, gjyqësore dhe atyre të pavarura;

Vlerëson:

- përpjekjet e Komisionit të Shërbimit Civil në zbatimin e detyrave të tij ligjore për sigurimin e një administrate profesionale dhe të paanshme;
- punën e bërë në ushtrimin e kompetencave të tij ligjore për shqyrtimin dhe zgjidhjen në mënyrë ligjore, objektive dhe transparente të ankesave të nëpunësve civilë ndaj vendimeve të administratës publike në lidhje me pranimin në shërbimin civil, periudhën e provës, ngritjen në detyrë, lëvizjen paralele, vlerësimin dhe të drejtat e tjera që parashikon statusi i nëpunësit civil;
- veprimtarinë e Komisionit të Shërbimit Civil në lidhje me ligjshmërinë dhe bazueshmërinë e vendimeve të tij gjatë procesit të ankimimit në gjykatë, si dhe punën e nisur për unifikimin e praktikave të deritanishme;

Kërkon për vitin 2005:

- rritjen e profesionalizmit të Komisionit të Shërbimit Civil dhe të administratës pranë këtij institucioni në ushtrimin e detyrave të tyre ligjore;
- krijimin e një klime bashkëpunimi efektiv në marrëdhëniet me institucionet e tjera;
- rritjen e rolit dhe aksesit të institucionit në përmirësimin e legjislacionit të shërbimit civil dhe akteve nënligjore të dala në zbatim të tij;
- mbikëqyrje më efektive për menaxhimin e shërbimit civil për krijimin e një situatë sa më të qëndrueshme në të gjitha nivelet e administratës publike, larg ndikimeve të politikës;
- përmirësimin në nivel të dukshëm të rolit të Komisionit të Shërbimit Civil, me qëllim mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit të shërbimit civil në nivelin e administratës së pushtetit vendor.